

VENDIM
Nr.499, datë 6.5.2009

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.384, DATË 20.5.1996 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MBROJTJEN E TË MITURVE NË PUNË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 103 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.384, datë 20.5.1996 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhet shtesa e mëposhtme:

1. Pas shkronjës “H”, “Pushimet”, shtohet shkronja “I” “Kontrolli mjekësor”, me këtë përmbajtje:

“I. Kontrolli mjekësor

9. Punëmarrësit e mitur, nën 18 vjeç, para fillimit të marrëdhënieve të punës duhet të paraqesin, pranë mjekut të ndërmarrjes, raportin e komisionit mjeko-ligjor, ku të deklaroheft aftësia e tyre për punë.

10. Punëdhënësi, gjatë marrëdhënieve të punës, duhet t’u garantojë punëmarrësve të mitur kontroll periodik mjekësor për gjendjen e tyre shëndetësore, të përshtatur edhe në funksion të rreziqeve, të cilat lidhen me punë, që ai kryen.

11. Kontrolli periodik mjekësor kryhet çdo:

a) 12 muaj punë, për punëmarrësit e mitur, nën 18 vjeç, të cilët janë të punësuar në punë të lehta;

b) 6 muaj punë, për punëmarrësit e mitur, nën 18 vjeç, të cilët janë të punësuar në punë të vështira, të përcaktuara në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

12. Punëdhënësi përballon shpenzimet për kontrollet periodike mjekësore të punëmarrësit të mitur dhe garanton ruajtjen e kufidencialitetit të çdo të dhëne, lidhur me gjendjen e tij shëndetësore.”.

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Shëndetësisë për kontrollin e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha